

ERIKETA KAMBO

**TENDENCIOZITETI IDEOLOGJIK MARKSIST-LENINIST
I SHKOLLËS SHQIPTARE
(1966-1970)**

Vitet 1966-1970, përfaqësojnë periudhën gjatë të cilës u iniciua “Reforma e re” për “revolucionarizimin e shkollës”, e cila la aq shumë pasoja në ecurinë e mëtejshme të të gjithë sistemit të edukimit shqiptar.

Mishërimi i plotë i ideologjisë marksiste-leniniste në gjithë veprimtarinë mësimore-edukative të shkollës dhe brenda këtij kuadri, pasqyrimi në dokumentacionin e saj, do të rishfaqej si një nga problemet komplekse pa zgjidhjen e të cilit nuk mund të garantohej ecuria e “reformës” së re. Nisur nga kjo optikë, zhvillimet në këtë drejtim u vlerësuan si “një nga punët më serioze” dhe fushë e rëndësishme ku konkretizohej “politika e PPSH”, qëllimi dhe programi i saj”. “Programet, - do të tërhiqte vëmendjen E.Hoxha, - kanë rëndësi vendimtare për shkollat e çdo kategorie. Për çdo lloj shkolle që do të përcaktohet duhet të bëhen programe të diferencuara dhe të rishikohen ose të hartohen tekstet përkatëse”¹.

Mundësitë e limituara të një artikulli kushtëzojnë analizën vetëm në aspektet më kryesore të saj, të fokusuara në disa prej ndryshimeve në bazat ideologjiko-shkencore të procesit mësimor-edukativ.

Drejtimet themelore të “reformës” arsimore u paraqitën nga Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, më 7 mars 1968.

“Tezat” e Enver Hoxhës u përpunuan në dokumente të mëtejshme shtetërore dhe partiake dhe përcaktuan linjat brenda të cilave u zhvillua diskutimi i problemeve në këtë fushë. Ky këndvështrim ishte i “vetëm” dhe pa alternativë tjetër. Në kuadër të “rishikimit kritik” të të gjitha planeve, programeve dhe teksteve mësimore, për forcimin e mëtejshëm të

¹ Enver Hoxha, “Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës”, Fjala në Byronë Politike të KQ të PPSH 7 mars 1968, *Vepra*, vëll.37, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 311-312.

karakterit të tyre klasor, filloi një “diskutim popullor”^{*}, me mendime të “hapura” për aq sa mund të quheshin të tilla. Nga një vështrim i kujdesshëm i përmbajtjes së ndryshimeve të realizuara, evidencohen disa veçori karakteristike që po i japim përmbledhtazi.

*

* *

1. Forcimi i karakterit klasor të dokumentacionit shkollor, shtimi i lëndëve të drejtpërdrejta politike

Në planet dhe programet e reja do të tentohej të futeshin elementë të edukimit politik, në forma të thjeshta dhe të veçanta, që nga klasat më të ulëta në ato më të larta. Ndër masat e para të kësaj periudhe do të ishte ajo që, duke filluar nga viti shkollor 1967-1968 lënda “Edukata qytetare dhe morale”, e emërtuar tashmë “Edukatë politike dhe morale”, të zhvillohej në dy klasat e fundit të tetëvjeçares. Lihej ndërkohë e hapur mundësia e hartimit të një programi të ri, ku kjo lëndë parashikohej të shtrihej në të ardhmen në të katër klasat e saj².

Vëmendje e veçantë iu kushtua forcimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional, të lëndëve politike. “Nxënësit e shkollës së mesme, - do të tërhiqte vëmendjen kryeministri i vendit, Mehmet Shehu, - duhet medoemos të marrin kulturë elementare marksiste-leniniste ... ajo që ka rëndësi është që, nxënësi të njohë historinë e partisë sonë, historinë e popullit shqiptar, bazat e marksizëm-leninizmit. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë, atëherë nuk përgatisim njeriun e

^{*} Pas publikimit të “Tezave” të fjalimit të E.Hoxhës të 7 Marsit 1968 “Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës” në të gjithë vendin do të organizohej një “diskutim i gjerë popullor” për njohjen dhe zbërthimin e tyre. Tematika “e rekomanduar” ndikoi fuqishëm në inkuadrimin e diskutimeve brenda “kornizash” të përcaktuara nga lart, ku padyshim një rol aktiv luajti shtypi zyrtar. “Diskutimi do të realizohej në dy faza. Në fazën e parë u bë studimi i thelluar i “tezave” nga organet dhe organizatat e partisë, strukturat shtetërore dhe organizatat e masave, specialistët e shkollës etj. Në fazën e dytë, u kalua drejt nga diskutimi në një stil të gjerë e të organizuar, ku u përfshinë të gjitha institucionet shkollore, trupat mësimore, nxënësit e moshës së pjekur dhe studentët, pedagogë e prindër, kuadro të prodhimit e masa e gjerë e punonjësve.

² Mehmet Shehu, “Për zbatimin e detyrave në lidhje me revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë”, në: *Arsimi Popullor*, nr.2, 1968, fl. 33.

kohës sonë ... Prandaj duhet t'u jepet prioritet sidomos atyre lëndëve, që kanë të bëjnë me formimin e boshtit ideologjik marksist-leninist”³.

Duke filluar nga viti 1967-1968, kursi njëvjeçar i lëndës “Njohuri fillestare të marksizëm-leninizmit” që zhvillohej në arsimin e mesëm, do të kthehej në kurs dyvjeçar. Në diskutimet për këtë lëndë do të këmbëngulej për përcaktimin e një strukture të re. Duke ruajtur elementet e filozofisë dhe të ekonomisë politike, do të futej Historia e PPSH. Kjo e fundit në shkollat e mesme pa shkëputje nga puna, parashikohej me sasi orësh më të reduktuara. Programet e përgatitura në këtë periudhë dhe të thelluara më vonë, sillnin ndryshime në drejtim të përshtatjes më të mirë të temave të trajtuara me kërkesat “aktuale”, si do të thuhej shpesh në dokumentet e kohës.

“Bazuar në njohuritë e nxënësve për shkencat shoqërore e natyrore, - do të komentonte Ministria e Arsimit në një analizë të programeve të kësaj lënde, - ... në kursin e ri, bëhet një përgjithësim elementar i këtyre njohurive nga pikëpamja e filozofisë marksiste, e teorisë së socializmit shkencor dhe të ekonomisë politike marksiste”. Vend të rëndësishëm në këtë kurs do të zinte “trajtimi i problemit të luftës kundër revizionizmit” gjë që ndihmonte sipas saj, në formimin e botëkuptimit marksist të nxënësve”⁴. Historia e PPSH tashmë do të trajtohej në klasën e 10-të të shkollës së mesme të përgjithshme dhe në të gjitha shkollat e larta, ku programi shtrihej nga dy në katër vite.

Në verën e vitit 1968, strukturat arsimore ndërmorën masa të reja praktike, që konsistuan në ndryshimet e nevojshme fillimisht në plane dhe më tej në programe. Për vitin shkollor 1968-69, planet e shkollës së arsimit të përgjithshëm pësonin dy ndryshime të dukshme. Lënda “Njohuri fillestare të marksizëm-leninizmit” shtrihej, nga dy në tri vite. Kjo e fundit do të zhvillohej në të njëjtat sasi orësh dhe në teknikumet. Zhvillimet e tjera kishin të bënin me shkollat e larta, ku lëndët e përgatitjes ideologjike renditeshin në një mënyrë të re, Historia e Partisë

³ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi (më tej: F.) 490, Viti (më tej: V.) 1967, Dosja (më tej: D.) 503, fl. 29-30, Nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, dt. 25.12.1967.

⁴ Po aty, F. 511, V. 1967, D. 37, fl.4.

së Punës së Shqipërisë (më tej: PPSH), Ekonomia Politike dhe Materializmi Dialektik dhe Historik⁵.

Procesi i thellimit të karakterit klasor të dokumentacionit shkollor nëpërmjet lëndëve të drejtpërdrejta politike erdhi duke u intensifikuar sidomos në vitin 1969, kur edhe diskutimet për “revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës” u futën në një fazë më të lartë. Në kuadrin e ndryshimeve të parashikuara në arsimin 8-vjeçar, do t’i kushtohej mjaft vëmendje hartimit të planeve e programeve të reja. Kriteri kryesor vijonte të mbetej ai i forcimit të edukatës dhe mësimit politik. Zhvillimi në një orë në javë i lëndës “Edukata politike dhe morale”, do të konsiderohej i pamjaftueshëm. Një mangësi në këtë drejtim do të quhej edhe disproporcioni midis termave me karakter qytetar dhe, atyre morale e politike. Në këto kushte u sollën disa variante, por si më i përshtatshëm u gjykua ai i zhvillimit të kësaj lënde në dy klasat më të larta, ku “... moshë e nxënësve si dhe studimi i bazave elementare të shkencave”, lejonte të arrihej në disa përgjithësime “të rëndësishme ideologjike dhe politike”, për forcimin e edukimit komunist të nxënësve⁶.

Sipas një opinioni të përgjithshëm zyrtar, lënda e marksizëm-leninizmit duhej të mësohej në të gjitha klasat e shkollës së mesme dhe se, organizimi më i përshtatshëm do të ishte ai i fillimit me Historinë e PPSH, për të vazhduar me marrjen e njohurive mbi filozofinë dhe ekonominë politike. Për sa i takon teksteve që realisht ishin mjaft të vështira, zgjidhja e ofruar do të ishte ajo e futjes së temave “të reja” nga aktualiteti deri në përgatitjen e teksteve të reja. Në arsimin e lartë zgjidhja shihej në renditjen e përshtatshme të lëndës së marksizëm-leninizmit, që siguronte një “perceptim” më të mirë të saj nga studentët. Në dy variante të ofruara, njeri nisej nga parimi i kalimit “nga konkretja tek abstraktja”, duke sugjeruar studimin fillimisht të Historisë së PPSH. Varianti tjetër nënkuptonte mësimin në vitet e para të filozofisë m-1, që mendohej se

⁵ *Po aty*, V. 1969, D. 98, fl.22-23, Nga informacioni i Ministrisë së Arsimit “Mbi masat tranzitore për revolucionarizimin e shkollës në vitin shkollor 1968-1969”.

⁶ *Arsimi Popullor*, viti 1969, nr.1, f. 32-33. Nga raporti i Ministrisë së Arsimit “Për revolucionarizimin e shkollës 8-vjeçare”.

krijonte lehtësi në kuptimin e saj, pasi “materializmi dialektik dhe historik” shërbente si “metodë shkencore për të gjitha shkencat”⁷.

Pas shumë diskutimesh, Plenumi VIII i KQ të PPSH*, në qershorin e vitit 1969, do të vendoste piketat kryesore mbi bazën e të cilave do të realizohej “revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës” dhe, në këtë kuadër edhe ato të ndryshimeve në dokumentacion. Në bazë të kriterëve tashmë “të aprovuara”, lënda “Edukata morale dhe politike” do të mësohej në dy klasat e fundit të shkollës 8-vjeçare, duke e rritur sasinë e orëve nga 36 në 66 orë. Për të gjitha shkollat e mesme të vendit, do të zbatohesh një program unik i lëndës “Njohuri fillestare të marksizëm-leninizmit”, duke filluar me Historinë e PPSH, dhe më tej, me nocionet elementare të ekonomisë politike dhe materializmit dialektik e historik. Vendosja e një cikli të plotë të lëndëve të drejtpërdrejta politike duke filluar nga hallkat më të ulëta në ato më të larta dhe, trajtimi i tyre si lëndë “të veçanta nga më kryesoret”, thellonte më tej procesin e futjes së ideologjisë marksiste-leniniste në çdo qelizë të procesit mësimor-edukativ.

*

* *

2. Lëndët shoqërore në fokus të ndryshimeve të kurrikulave mësimore

Ndryshimet prekën dukshëm lëndët shoqërore sidomos historinë, gjuhën dhe letërsinë. Duke filluar nga viti shkollor 1966-1967 lënda e gjuhës, këndimi dhe deri abetarja në shkollën fillore u “pasuruan” me tema aktuale si, “heroizmi në punë dhe në mbrojtje, lufta kundër

⁷ *AQSh*, F. 490, V. 1969, D. 483, fl.550-554, Nga raporti i Komisionit Qendror për Arsimin paraqiten në Këshillin e Ministrave “Mbi ciklin e lëndëve të m-l në shkollën 8-vjeçare dhe të mesme.

* Plenumi VIII I KQ të PPSH (1969), forum i lartë partiak i mbajtur më 26-28.06.1969, punimet e të cilit iu kushtuan shqyrtimit të konkluzioneve të “diskutimit popullor” për “revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës” të bazuara në “Tezat” e parashtruara nga E.Hoxha në fjalën e mbajtur në Byronë Politike të KQ të PPSH më 7 mars 1968. Theksi do të vihej sidomos në drejtim të përvojës së shkollës, forcimit ideologjik marksist-leninist të të gjithë procesit mësimor-edukativ, i dhanë përparësi absolute edukimit ideopolitik të rinisë dhe formimit të botëkuptimit materialist shkencor të saj nëpërmjet forcimit të tendenciozitetit ideologjik të të gjitha lëndëve mësimore.

zakoneve prapanike dhe fesë, problemi i gruas, vënia e interesit të përgjithshëm mbi atë personal”⁸ etj.

Nga pikëpamja e volumit, në këtë fazë të parë lëndët humanitare nuk pësonin ndryshime të rëndësishme në planet dhe programet e arsimit të mesëm të përgjithshëm por, ato u reduktuan ndonëse jo në përmasa të dukshme, në shkollat profesionale. Arsyetimi i përdorur ishte nevoja e forcimit të njohurive të specialitetit, lidhur kjo me përgatitjen më të mirë të nxënësve për të punuar drejtpërdrejtë në prodhim. Në teknikume lëndët e kulturës së përgjithshme nga 40 për qind që trajtoheshin më parë, zinin tani vetëm 30 për qind të planit mësimor. Shkurtime ishin më të dukshme në teknikumet bujqësore, rreth 10-15 për qind më pak orë mësimore në lëndët humanitare. Mendohej që gjuha dhe gjeografia ekonomike e Shqipërisë, të mos trajtohej më në këtë kategori shkollash dhe lënda e historisë, të shkrihej në një program të vetëm me atë të Njohurive fillestare të marksizëm-leninizmit.⁹

Krahas lehtësimit nga mbingarkesa dhe informacioni i vjetruar, u tentua edhe drejt ndryshimeve që preknin organizimin e brendshëm të materialit lëndor. P.sh. një mendim i hedhur në këtë periudhë ishte ai që, programet e reja të historisë të jepnin vetëm disa njohuri të përgjithshme për periudhat e hershme, duke u fokusuar më tepër në ato pasardhëse. Por kjo sipas një pjese të hartuesve, rrezikonte “ta shndërronte mësimin në një skemë sociologjike abstrakte të zhveshur nga materiali konkret historik dhe, të vështirë për t’u kuptuar nga nxënësit”¹⁰. Strukturat partiake dhe ato shtetërore u treguan veçanërisht “të kujdesshme” dhe të ndjeshme, sidomos në çështjen e pasurimit të programeve me ato koncepte që specifikoheshin si të reja, “mbi klasat dhe luftën e klasave”, rolin e masave dhe lëvizjeve revolucionare në Shqipëri, zgjerimin e tematikës nga historia e Luftës Nacionalçlirimtare dhe ajo e ndërtimit socialist etj.¹¹

Brenda kuadrit të ndryshimeve të para, një dimension i ri iu dha lëndës së letërsisë, e lidhur kjo me forcimin e rolit të saj për “revolucionarizimin e rinisë shkollore”. Studimi i letërsisë shqipe u zgjerua duke zënë 15 për qind të programit të shkollës së mesme të

⁸ *AQSh*, F. 490, V. 1967, D. 27, fl. 2-3.

⁹ *Po aty*, F. 511, V. 1966, D. 19, fl. 11-12.

¹⁰ *Po aty*, F. 14, V. 1968, D. 51, fl. 43.

¹¹ *Po aty*, fl. 43-44.

përgjithshme dhe, ajo e realizmit socialist afro 60 për qind të tij. Pjesa e “përmirësimeve” ishte edhe përzgjedhja “me kritere më të shëndosha i autorëve dhe veprave të tyre”. Në letërsinë e huaj gjithnjë e më tepër zë vend “Letërsia revolucionare”¹².

Një analizë kritike do t’i bëhej dokumentacionit ekzistues në lëndën e historisë, sidomos të atij të shkollës 8-vjeçare dhe të mesme. Në shtypin qendror dhe atë lokal gjithnjë e më shpesh do të evidencohej nevoja e ndryshimeve “rrënjësore”, sidomos të teksteve të historisë botërore “të ndërtuara, - sipas mendimit të vetë Enver Hoxhës, - me kritere të ndryshme politike dhe ideologjike të papërshtatshme për shkollën tonë të re socialiste”¹³. Polemika ngjalli edhe çështja e shtrirjes së lëndës së gjeografisë në planin mësimor të kategorive të ndryshme shkollore dhe veçanërisht, ato të përmbajtjes si: sa pasqyroheshin ligjet e materializmit dialektik, a shiheshin të lidhura me njëra-tjetrën fenomenet e natyrës, a jepnin një sistem të plotë zhvillimi të pandërprerë të ambientit gjeografik, cilat do të ishin kriteret e studimit të vendeve të botës etj.¹⁴

Pas një periudhe të gjatë diskutimesh, në verën e vitit 1969, strukturat partiake dhe ato shtetërore ndërmorën masa të reja, që thelluan ndryshimet e nisura në përmbajtjen klasore të dokumentacionit shkollor. “Qëllimi ynë, - do të nënvizohej në konkluzionet e diskutimit popullor, - do të jetë që të forcohet tendencioziteti politik në të gjitha lëndët mësimore”¹⁵. Procesi preku të gjitha kategoritë shkollore, nga më të ulëtat në ato më të lartat. Në lëndët e shkencave natyrore pa shumë ndryshime në plane, u tentua për futjen në programe të një cikli të thjeshtë detyrash praktike apo vrojtimesh, që mendohej se i ndihmonin nxënësit për një kuptim “më të thellë” të fenomeneve. Kujdes bëhej sidomos për forcimin e boshtit ideologjik, si në lëndët e formimit të përgjithshëm ashtu edhe në ato të specialitetit, veçanërisht në shkollat e mesme profesionale dhe ato të larta. Përpjekjet u intensifikuan sidomos, në drejtim të lidhjes më organike të përmbajtjes të dokumentacionit të ri “me jetën e vendit, me sukseset e ndërtimit socialist”¹⁶.

¹² *Po aty*, F. 490, V. 1967, D. 27, fl. 3.

¹³ E. Hoxha, “Revolucionarizimi i mëtejshëm ...”, f. 316.

¹⁴ *AQSH*, F. 14, V. 1968, D. 293, fl. 76.

¹⁵ *Arsimi popullor*, 1969, nr. 4, fl. 76.

¹⁶ *AQSH*, F. 511, V. 1968, D. 98, fl.28-29, Nga informacioni i Ministrisë së Arsimit “Mbi disa masa tranzitore për revolucionarizimin e shkollës në vitin 1968-1969”.

Për forcimin e boshtit ideologjik, në arsimin 8-vjeçar dhe të mesëm u punua për përmirësimin e raporteve midis historisë deri në periudhën mesjetare me historinë e re, në favor të kësaj të fundit, midis historisë së përgjithshme dhe asaj botërore etj. Periudhës së ndërtimit socialist dhe Luftës Nacionalçlirimtare, i jepej përfaqësisht 30 për qind e orëve. “Kursi i veçantë i Historisë së Shqipërisë, krahas historisë së partisë sonë, - thuhej në një material të Ministrisë së Arsimit, - do të luajë një rol themelor në edukimin patriotik dhe ideopolitik të nxënësve”¹⁷. Në mënyrë specifike forcohej dukshëm, karakteri klasor në përmbajtjen e programit të letërsisë shqipe dhe asaj të huaj. Në shkollën 8-vjeçare, letërsia e realizmit socialist zinte 70 për qind të totalit të orëve, letërsia e Rilindjes, Pavarësisë dhe periudhës mid dy Luftërave Botërore, 20 për qind dhe ajo e huaj vetëm 10 për qind¹⁸. Në shkollën e mesme vendoseshin gjithashtu raporte të reja. Letërsia shqipe zinte 87 për qind të orëve dhe ajo e huaj 13 për qind. Brenda vetë lëndës së letërsisë, rritej dukshëm pesha e asaj të “realizmit socialist”. Në programet e reja, studimi i letërsisë së vjetër reduktohej “në një vështrim panoramik”, duke i dhënë vendin kryesor krijimtarisë letrare nga Rilindja Kombëtare e deri në periudhën bashkëkohore, me një fokusim në letërsinë e “realizmit socialist”¹⁹. Kjo e fundit tashmë zinte 67 për qind të programit, kurse letërsia e vjetër vetëm 33 për qind të tij. Si sasi, orët e parashikuara për letërsinë shqipe të “realizmit socialist” ndryshonin, nga 88 në 110 orë, kursi i folklorit nga 30 në 50 orë dhe letërsia e huaj botërore tkurrej dhe reduktohej në rreth 30 orë.

Ndryshimet u realizuan në përputhje me “orientimet” e strukturave më të larta partiake që, nga letërsia e kaluar kombëtare apo e huaj duhej të mësoheshin vetëm “ata përfaqësues kryesorë” që qëndronin “në pozita relativisht më përparimtare, demokratike e revolucionare”²⁰. Kjo përzgjedhje e autorëve, siç evidencohej në konkluzionet e Plenumit VIII të KQ të PPSH në qershorin e vitit 1969, do të bëhej para së gjithash “sipas rëndësisë edukative-revolucionare të krijimtarisë së tyre”, duke

¹⁷ *Po aty*, fl. 23.

¹⁸ *Arsimi Popullor*, 1969, nr. 1, fl.41, Nga raporti i Ministrisë së Arsimit “Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës tetëvjeçare”.

¹⁹ *AQSH*, F. 511, V. 1968, D. 98, fl. 23-26, Nga informacioni i Ministrisë së Arsimit “Mbi masat tranzitore për revolucionarizimin e shkollës në vitin shkollor 1968-1969”.

²⁰ *Arsimi popullor*, nr. 4, 1969, fl. 76-79.

specifikuar se një seleksionim i tillë do të ishte “rigoroz” sidomos për autorët e huaj²¹. Përqendrimi i vëmendjes në hartimin e një dokumentacioni të ri shkollor që “të materializonte” vijën politike të PPSH e thelloi edhe më tej procesin e shndërrimit të shkollës në mjet gjithnjë e më të fuqishëm për indoktrinimin e gjeneratave të reja me ideologjinë komuniste.

*

* *

3. Ndryshimet në tekstet mësimore të lëndëve shoqërore - kërkesë ultimative e Partisë- shtet

Sipas një informacioni të Ministrisë së Arsimit të korrikut të vitit 1966, në hartimin e teksteve ishin bërë përpjekje duke i dhënë rëndësi “heqjes dorë nga përkthimet e panevojshme dhe hartimit të tyre nga autorët tanë, forcimit të karakterit ideopolitik të përmbajtjes dhe shkarkimit nga faktet, konceptet dhe njohuritë e hollësishme”²². Por gjithsesi, në vija të përgjithshme tekstet ishin larg “standardeve” që kërkonte partia –shtet. Parë nga këndvështrimi i këtyre interesave, tekstet duhej t’i nënshtroheshin ndryshimeve më themelore. Këtu ndërthureshin dy probleme, pamjaftueshmëria e teksteve dhe përshtatja më e mirë ndaj “kërkesave të kohës”. Për sa i takon problemit të parë, mungesa e teksteve ishte evidente në shkollat profesionale dhe në Universitet, ku duhej të përgatiteshin rreth 1000 tekste të reja²³.

Ajo çka do të konsiderohej më e papranueshme do të ishin “dobësitë në përmbajtje”, më të theksuara në tekstet e lëndëve shoqërore. Kishte ende shpërpjesëtime midis materialit tradicional, nga atij që quhej “material i ri” ose “aktual”. Të meta të rëndësishme nga pikëpamja e përmbajtjes do të konsideroreshin kombinimi i pamjaftueshëm i materialit mësimor i natyrave të ndryshme, si dhe lidhja jo e duhur e teorisë me praktikën. Tekstet ekzistuese ose ishin shumë teorikë ose tepër përshkrues, si dhe u mungonin përpjesëtimet e duhura të materialit mësimor sipas natyrës së çdo lënde. Kjo çonte përpos të tjerave edhe në ngarkesa e një volum më të madh të tyre. Këtyre u shtoheshin defektet nga pikëpamja e paraqitjes deduktive të lëndës, trajtimit problemor,

²¹ *Po aty*.

²² *AQSH*, F. 511, V. 1966, D. 37, fl. 7-8.

²³ *Po aty*, F. 490, V. 1967, D. 583, fl. 3.

përballimit të dobët “të tezave të kundërta ... evidentimit të ideve boshtore” etj.²⁴

Nga ana e përmbajtjes ideologjike, siç do të tërhiqej vëmendja në një artikull të gazetës “Mësuesi” të dhjetorit të vitit 1967, “tekstet nuk i përgjigjen sa duhet thellimit të mëtejshëm të revolucionit ideologjik kultural”. “Parime të rëndësishme”, vijohej më tej, “si roli i masave, vënia e politikës në plan të parë, metoda e analizës klasore në shqyrtimin e fenomeneve shoqërore etj., dalin mjaft zbehtë në tekstet tona”²⁵.

Nisur nga gjendja reale, përmirësimi i thellë i teksteve mësimore do të vlerësohej nga drejtuesit e lartë të arsimit, si një problem i vështirë dhe kompleks që kërkonte angazhim serioz të të gjithë strukturave dhe specialistëve të kësaj fushe. “Ne jemi munduar që tekstet t’i ruajmë nga gabimet ideologjike, do të thuhej në një informacion të Ministrisë së Arsimit të fundit të vitit 1967.... Ndoshta çështja e teksteve kërkon një kohë më të gjatë për t’u bërë. Megjithatë ne do të punojmë dhe do të vazhdojmë t’i përmirësojmë”²⁶

Trajtimi “i kujdesshëm” i këtij problemi do të komentohej nga strukturat e larta shtetërore e partiake, si “pesimizëm që nuk përputhej me gjithë situatën revolucionare” që përshkonte jetën ekonomike e shoqërore të vendit në këto momente. Ky reagim i ashpër i shfaqur dukshëm në një mbledhje të Këshillit të Ministrave në dhjetorin e vitit 1967, do t’i vinte nën presion strukturat mësimore dhe specialistët e angazhuar të kësaj fushe. “Gjithë diskutimi tënd, - do t’i drejtohej Kryetari i Këshillit të Ministrave, M. Shehu, Ministrit të atëhershëm të Arsimit, Thoma Deliana, - në lidhje me tekstet, është pesimist. Jo vetëm që nuk po bën gjë me tekstet, por edhe atë që do të bëni, thoni se nesër do ta përmbysni se ndryshon jeta”²⁷.

Ideja ishte të realizohej rishikimi i të gjitha teksteve pa përjashtim, që nënkuptonte se ky proces do të shtrihej nga abetarja e deri në tekstet e shkencave natyrore apo të filozofisë. Gjithnjë sipas burimeve të kohës “Brendia ideologjike e teksteve, ndonëse përshkohet nga ideologjia marksiste-leniniste, nuk u përgjigjet plotësisht kërkesave aktuale të

²⁴ *Po aty*.

²⁵ “Mbi rrugët e përmirësimit të teksteve shkollorë”, gazeta *Mësuesi*, 8 dhjetor 1967, fl. 2.

²⁶ *AQSH*, F. 490, V. 1967, D. 583, fl. 3, Nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, dt. 25 dhjetor 1967.

²⁷ *Po aty*, fl. 5-6.

shkollës së sotme, në etapën e re të thellimit të revolucionit ideologjik e kulturor”²⁸.

Fjalimi i Enver Hoxhës më 7 mars 1968 në Byronë Politike, projektoi linjat kryesore se si do të zhvillohej edhe ky proces. Tekstet e të gjitha disiplinave do të “analizoheshin” për të përcaktuar se, “çfarë ishte e drejtë” apo e “gabuar”. Kriteri bazë mbetej “gjykimi” nga pikëpamja e analizës “klasore”. Prej teksteve do të hiqej çdo gjë që konsiderohej e huaj për botëkuptimin materialist-dialektik. Në lëndët e shkencave humanitare, ku me gjithë ndryshimet e pjesshme, nuk përdroreshin “kriteret e shëndosha”, gjendja mendohej si shqetësuese dhe e rrezikshme. Nisur nga kjo premisë, rishikimi i teksteve bëhej detyrë urgjente. Enver Hoxha në fjalimin e tij kritikoi gjendjen e teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore, sepse në to konstatoheshin “... jo vetëm dobësi, çrregullime, shpërpjesëtime, amatorizëm, pasion dhe erudicion i sëmurë, por edhe gabime të rënda”²⁹ që kishin kosto.

Pikëpamjet e “papastruara” mirë, apo preferencat për një autor të huaj “... të transmetuar në shkollë apo në jetë nëpërmjet mësimet, leksioneve, konferencave apo shtypit”, Hoxha i etiketoi jo vetëm “të papranueshme” dhe “të patolerueshme” por edhe “të rrezikshme”. Sipas tij “... në qoftë se nuk vemë rregull në këto çështje, ne kemi lejuar dhe i kemi bërë koncesione filozofisë borgjeze të na luftojë hapur, gati zyrtarisht në terrenin tonë”³⁰. Një qëndrim i tillë do të thellonte procesin e mbylljes ndaj letërsisë botërore në përgjithësi, duke çuar si edhe çoi në varfërimin e mendimit, të shfaqur dukshëm në gjithë krijimtarinë kulturore të mëvonshme. Sipas Hoxhës, procesi selektiv duhej bërë ndaj çdo krijimtarie letrare botërore, sepse problemi ishte “delikat” dhe nuk duhej lejuar “...as snobizëm, as shijet individuale, as shijet e sëmura”.

Në hartimin e programeve dhe teksteve të letërsisë, në organet e shtypit apo në përkthimet, porosia do të ishte që “njerëzit që do të bënin këtë përzgjedhje”, detyrimisht duhej të kishin jo vetëm një kulturë të gjerë por para së gjithash edhe “pikëpamje marksiste-leniniste të formuara”³¹. Vetëm kështu këta të fundit do të kishin të qarta qëllimet e

²⁸ *Po aty*, F. 14, V. 1968, D. 293, fl. 57-58, Nga Buletini nr.3 i Komitetit Qendror të Arsimit, gusht 1968.

²⁹ E. Hoxha, “Për revolucionarizimin ...”, Fjalim në BP të KQ të PPSH, 7 mars 1968, Vëll. 37, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, fl. 319-320.

³⁰ *Po aty*, fl. 320.

³¹ *Po aty*, fl. 326.

caktuara dhe synimet e PPSH. E thënë ndryshe, çdo pjesë nga letërsia botërore konsiderohej “jo e plotë”, dhe do t’u jepej nxënësve, studentëve dhe publikut të gjerë, duke kaluar më parë në “filtrin” e saj, duke mos u “përthypur e tëra”³² por vetëm ato pjesë që i shkonin për shtat filozofisë ideologjike të PPSH.

Analizës “kritike” në prizmin e dialektikës materialiste, do t’i nënshtrohej edhe lënda e historisë të letërsisë shqipe. Shembulli më domethënës do të ishte rishikimi i epokës së Rilindjes dhe Rilindasve, që jo rrallëherë PPSH u ishte referuar për të revokuar të kaluarën e lavdishme, të konsideruar deri diku si një “tabu”. Prekja e saj linte të kuptohej se, “spastrimi” dhe “analiza” nga pozitat e filozofisë marksiste-leniniste nuk do njihte limite, duke prekur të gjitha fushat pa përjashtim.

Të konsideruar masat e marra deri në këtë periudhë si të pamjaftueshme, u këmbëngul për një thellim të mëtejshëm të procesit të ndryshimeve. “Rilindasit, - theksonte Enver Hoxha, - duhet të vihen drejt në epokën kur kanë jetuar, punuar dhe luftuar, duhet të vihen në dukje idetë e tyre, të cilat ishin prodhim i zhvillimit të shoqërisë të asaj epoke ...”³³. Por ajo nga e cila tashmë duhej “ruajtur” do të ishte fakti se, nuk duhej harruar “për asnjë çast se po këta rilindas kishin anët e tyre negative, që duhej t’i nënshtroheshin kritikës marksiste-leniniste”. Kjo nënkuptonte që në trajtimin e kësaj çështje nuk do të kishte skrupuj. “T’i konsiderojmë tabu, – do të shtronte pyetjen Hoxha - vetëm për faktin se jam rilindës?” Dhe po vetë përgjigjej: “Jo, si marksistë dhe për interes të popullit e të socializmit, ne duhet t’i luftojmë këto anë negative. Në ideologji nuk mund t’i bëjmë koncesion vargut ose gjuhës”³⁴.

Qëndrimi imponues për një mendim të unifikuar me pretendimin e etalonit të të vërtetës, do të vinte nën presion çdo intelektual, duke çuar në përzgjedhjen e krijimtarisë politike e letrare të rilindësve, në varfërimin e informacionit për këtë periudhë të ndritur të historisë së popullit shqiptar dhe njohje të njëanshme, me justifikimin se konsideroheshin “të drejta” nga udhëheqja e vendit. Në këtë kuadër do të prekej edhe çështja e raporteve, midis historisë dhe letërsisë të paraluftës me atë të mëvonshme, dhe do të bëhej një “rivlerësim” i kësaj të fundit për të rritur begraundin politik të PPSH.

³² Po aty.

³³ Po aty, f. 322.

³⁴ Po aty, f. 324.

Fjalimi i Enver Hoxhës më 7 mars 1968 u bë “bibël” për gjithë procesin e diskutimeve për revolucionarizimin e shkollës. Mbi këtë bazë, tekstet ku duhej të materializohej vija politike e shpalosur në atë fjalim, gjithnjë e më tepër u bënë objekt analizash. *Spastrimi, ripunimi dhe hartimi i teksteve të reja, u bënë pjesë e procesit të revolucionarizimit të shkollës.*

Hartuesit e teksteve duhej para së gjithash të kishin besueshmërinë politike. Në grupet e punës kërkoheshin të përfshiheshin “kuadro që të kenë përgatitje dhe botëkuptim marksist-leninist” dhe, pastaj të ishin të aftë nga pikëpamja e profilit, e specialitetit dhe zotërues të metodave pedagogjike³⁵. Duke iu referuar burimeve zyrtare, në verën e vitit 1968, u ndërmorën masa të reja “për të realizuar me cilësi, si dhe në kohën e duhur, detyrat e ngarkuara në këtë drejtim”. Ministria e Arsimit, do të kërkonte nga drejtuesit e shkollës dhe këshillit pedagogjik që “herë pas here, të analizonin punën e mësuesve të përfshirë në grupet e punës për hartimin e teksteve”³⁶.

Diskutimi dhe hartimi i teksteve të reja, ashtu si edhe i planeve e programeve, përfaqësonte një proces gradual që do të thoshte se ato nuk do të hiqeshin menjëherë nga qarkullimi por, do tentohej për të bërë “rregullimet e duhura”. Krahas tyre do të punohej për të hartuar të reja. Pra, për një periudhë shkollat e vendit do të vijonin të përdornin tekstet ekzistues. Në këto kushte, Ministria e Arsimit ndërmori një sërë masash transitore për vitin shkollor 1968-1969. Ripunimit iu nënshtuan fillimisht tekstet e lëndëve humanitare, që konsideroheshin se “kishin të meta të rëndësishme”. Kështu p.sh. u hartuan thujse të reja, të gjitha tekstet e antologjive letrare të shkollës 8-vjeçare dhe asaj të mesme, me arsyetimin e mbizotërimit në to të pjesëve “nga letërsia shqipe e së kaluarës” dhe, të mungesës së pasqyrimin të letërsisë të dekadës së fundit. Në antologjitë e reja përzgjedhja bëhej nga pjesë të letërsisë së “realizmit socialist”³⁷.

Për të mënjeluar “dobësitë e theksuara ideologjike e letrare” të librave të këndimit të shkollës filllore, u përgatitën tekste të reja këndimi për klasën e parë dhe të dytë, duke shfrytëzuar sipas një raporti të Ministrisë së Arsimit të kësaj periudhe, pjesët më të mira “të letërsisë feminare me përmbajtje të shëndoshë ideologjike e morale”. Një

³⁵ *Arsimi Popullor*, nr. 2, 1968, f. 36.

³⁶ *Po aty.*

³⁷ *Po aty.*

redaktim i pjeshëm mbi bazën e “analizës ideo-klasore të veprimtarisë letrare” të klasikëve të letërsisë vendase dhe të huaj, iu bë teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore, si dhe u rishikua përmbajtja e ushtrimeve dhe copave të gjuhës shqipe dhe asaj të huaj³⁸. Teksti “Gjeografia ekonomike e shteteve” për shkollën e mesme, u zëvendësua me një tekst të ri, ku dilnin në pah më mirë veçoritë e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit. Për sa i takon atyre të historisë sidomos për shkollën e mesme, u bënë përpjekje për ndryshime në raportet midis materialit të së kaluarës dhe atij “aktual”, me tendencën e zgjerimit të këtij të fundit³⁹.

Në shkencat e natyrës si në fizikë, kimi, biologji etj., u bënë përpjekje për të lidhur më mirë ligjet e natyrës me çështje të caktuara të filozofisë marksiste. Kështu u interpretuan nga pozitat e filozofisë natyraliste dialektike p.sh. ligji i ruajtjes së energjisë apo i nocioneve mbi materien dhe lëvizjen. Në këtë kuadër iu kushtua vëmendje edhe goditjes të “një vargu pikëpamjesh fetare e idealiste në tema të veçanta”. Për të mënjeluar “të metat ideologjike”, në vitin shkollor 1968-1969, u ripunua teksti “Biologjia e përgjithshme”, me synimin e forcimit të botëkuptimit materialist-dialektik të nxënësve.

Për lidhjen e përmbajtjes së teksteve me jetën e vendit, shumica e librave me karakter politik, ekonomik, organizativ, u zëvendësuan me të reja. Tekstet e shkollave të mesme profesionale iu nënshtuan rregullimeve dhe një pjesë u hartuan nga e para, duke futur “eksperiencën shqiptare” në bujqësi, industri etj. Gjithsesi, megjithëse u tentua tekstet e reja mbetën problematike. Shumica ishin përmbledhje të teksteve të shkollave të larta, apo përkthime dhe adaptime shpesh herë të dobëta. Për më tepër vëreheshin edhe mungesa nga pikëpamja sasiore. Në vitin shkollor 1968-1969 nxënësit do të punonin me vetëm 50 për qind të teksteve të nevojshme⁴⁰.

Procesi u thellua dhe si do të përmendej gjithnjë e më shpesh nga strukturat më të larta partiake e shtetërore, gjatë periudhës të “diskutimit popullor” dhe në vijimësi, ai do të ishte një nga “aksionet më të mëdhenj” ku u angazhuan institucionet më të larta arsimore të vendit si

³⁸ *AQSH*, F. 511, V. 1968, D. 98, fl. 28-29, Nga informacioni i Ministrisë së Arsimit “Mbi disa masa tranzitore për revolucionarizimin e shkollës në vitin shkollor 1968-1969”.

³⁹ *Po aty*, fl. 29.

⁴⁰ *Po aty*, fl. 29-30.

Universitetit e shkollat e tjera të larta, Instituti i Historisë, Gjuhësisë, Lidhja e Shkrimtarëve etj. Në një periudhe dyvjeçare, parashikohej përgatitja e rreth 500 teksteve për shkollën 8-vjeçare dhe atë të mesme. Në këtë veprimtari u përfshinë rreth 3800 mësues, pedagogë e specialistë dhe 780 grupe pune, të cilët punuan për pasqyrimin në to të të dhënave të reja, evitimin e ngarkesës së tepërt mësimore, si dhe paraqitjen e jashtme teknike⁴¹.

Strukturat shtetërore e partiake në udhëzimet e tyre këmbëngulnin para së gjithash që në përputhje me moshën dhe kategorinë arsimore, tekstet të përshkoheshin më “organikisht nga ideologjia marksiste-leniniste, duke realizuar formimin komunist të nxënësve”. Ne jemi të ndërgjegjshëm deklaronte Ministri i Arsimit Thoma Deliana në qershorin e vitit 1969 se, në punën për revolucionarizimin e mëtejshëm të teksteve shkollore “kemi për të kapërcyer mjaft vështirësi ... Prandaj përpjekjet tona po i përqendrojmë në radhë të parë për të ndihmuar grupet e punës, sidomos në realizimin e boshtit ideologjik në lëndë të ndryshme sipas specifikës së tyre”⁴². Përmbajtja duhej të realizonte edhe lidhjen më të mirë, të mësimin me punën prodhuese si dhe përgatitjen fizike-ushtarake.

Ashtu si dhe për programet, në këtë fazë të reformës u përpunuan kriteret bazë, që gjetën pasqyrim në dokumente të rëndësishme orientuese të strukturave më të larta shtetërore e partiake. Në një buletin të veçantë të Komisionit Qendror për Arsimin* të fundit të vitit 1969, do të tërhiqej vëmendja që në hartimin e teksteve të reja, duhej gjithmonë të mbahej parasysh “... zgjedhja dhe trajtimi i ideve kryesore të shkencës në dritën e teorisë marksiste-leniniste”, që nënkuptonte përzgjedhje të pastër politike ...“të fakteve, koncepteve, pikëpamjeve dhe teorive”, një analizë klasore “të fenomeneve shoqërore” apo ngjarjeve historike, veprave letrare, evidencimin e “rolit të masave” në të gjitha fushat e jetës etj. Në përputhje me këtë linjë do të shfrytëzoheshin të gjitha mundësitë, për ta

⁴¹ Th. Deliana, “Zhvillimi i pedagogjisë sonë me hapa të shpejta duhet konsideruar si një mision me rëndësi historike”, në: *Arsimi Popullor*, nr. 4, 1969, f. 107.

⁴² Po aty.

* Komisioni Qendror për Arsimin pranë KQ të PPSH, u krijua në prillin e vitit 1968 si organ ndihmës për marrjen e masave për “revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës”. Në përbërjen e tij u krijuan edhe disa nënkomisione dhe grupe pune si ai i analizës së shkollës, sistemit arsimor, përmbajtjes të lëndëve të kulturës së përgjithshme, arsimit profesional etj. Komisione për arsimin u krijuan ndërkohë edhe pranë çdo komiteti partie në rrethe të ndryshme të vendit.

lidhur sa më ngushtë “materialin mësimor, me shpjegimet dhe interpretimet ideologjike edhe për lëndët e shkencave natyrore me synimin e forcimit të botëkuptimit materialist-dialektik të nxënësve” etj.⁴³

Me pretekstin e forcimit të fizionomisë kombëtare, tekstet e reja të shkencave shoqërore duhej të realizonin lidhje më të mirë me politikën e PPSH. Në këtë këndvështrim u rishikuan tekstet e abetares, këndimit, antologjitë letrare, të gjuhës shqipe, të historisë dhe të gjeografisë së Shqipërisë, që do të përshkohen tashmë nga “fryma e shëndoshë” dhe “hovi revolucionar” që përjetonte vendi. Një shqetësim përbënte edhe fakti se si do të realizohej nga pikëpamja metodike boshti ideologjik m-l. Nga strukturat arsimore për klasat e fillores procesi mendohej se ishte më i thjeshtë. Ai do të kryhej “me sukses” duke shfrytëzuar copat e leximit, që sillnin shembuj apo sqarime ideologjike dhe përgjithësime të thjeshta. Në tekstet e përgatitura për klasat më të larta të shkollës 8-vjeçare, do të duhej të gjenin vend më shumë analiza, lufta e pikëpamjeve midis atyre që konsideroheshin “të drejta” dhe atyre “reaksionare”, etj. Në shkollën e mesme do të bëhej kujdes që tekstet të përmbanin një paraqitje historike të teorive, duke iu kundërvënë atyre “reaksionare”, analiza klasore të fenomeneve shoqërore apo përgjithësime ideologjike, të bazuara në mësimet e lëndëve të caktuara si dhe njohurive të fituara nga lëndët e drejtpërdrejta politike⁴⁴.

Lidhja e mësimet me prodhimin dhe edukimin fizik e ushtarak përbënte një nga synimet e rëndësishme në fushën e teksteve. Ajo mbështetej në “parimin e politeknizimit të njohurive”, që nënkuptonte futjen e njohurive më të gjera teknike e profesionale në përmbajtjen e tyre, pasqyrimin më të mirë të të rejave të shkencës dhe teknikës dhe kombinimin më efikas, me eksperiencën e ndërtimit socialist të vendit etj. Të gjitha këto kritere shërbyen si bazë kryesore për hartimin e programeve dhe teksteve.

Në funksion të forcimit të përmbajtjes ideologjike të dokumentacionit të ri shkollor u realizuan edhe disa ndryshime strukturore.

Në procesin e revolucionarizimit të shkollës u tentua të realizohej një shtrirje më uniforme e lëndëve, renditje apo ndarje e ndonjë discipline, futje të lëndëve të reja etj. Kështu dituria e natyrës dhe gjeografia të

⁴³ AQSH, F. 14, V. 1970, D. 301, fl. 24-25, Nga Buletini nr. 14 i Komisionit Qendror për Arsimin, Tiranë, janar 1970.

⁴⁴ Po aty, fl. 26.

trajtuara së bashku në shkollën 8-vjeçare, tashmë do të zhvillohen si dy disiplina më vete. Dituria e natyrës shtrihej në 3 vjet dhe, biologjia e përgjithshme me qëllim të shfrytëzimit më efikas të njohurive nga lëndët e tjera si fizika apo kimia, zhvendosej nga klasa e parë në atë të katërt. Për programet do të kërkohet që ato të përmbanin, "...lëndën e domosdoshme për formimin ideologjik e shkencor, të lidhen me problemet e ndërtimit socialist të vendit tonë, të futen elementet e reja të shkencës në kuptimin e modernizimit të shkollës, të pastrohen nga gjërat e tepërta, të panevojshme etj."⁴⁵

"Përmirësimet" konsistuan në hapjen e ciklit të mbyllur të disa lëndëve të klasave të ulëta dhe atyre më të larta dhe kombinimin më të mirë të parimit koncentrik e linear në trajtimin e lëndëve. Sipas projektplanit të propozuar gjatë diskutimit për shkollën tetëvjeçare në shkurtin e vitit 1969, rezultonte se në total, sasia e përgjithshme e orëve kapte shifrën e 7642 ose 32 orë më tepër nga plani ekzistues. Parë nga këndvështrimi i raporteve midis lëndëve, shkencat shoqërore si gjuhë, lexim, gjuhë e huaj, histori, gjeografi, edukata politike e morale, zinin 3227 orë ose 42,2 për qind të të gjithë kohës së mësimit. Për lëndët e shkencave të natyrës do të përdroreshin 2200 orë, ose afërsisht 28,7 për qind dhe lëndët e vizatimit, muzikës, kulturës fizike, mësimit të punës 2215 orë, ose 28,8 për qind e kohës mësimore⁴⁶.

Në mënyrë specifike, zhvillimet më të rëndësishme u vërejtën në planet dhe programet e shkollave të mesme të përgjithshme dhe sidomos atyre profesionale, lidhur me prioritetin që merrnin këto të fundit. Synimi ishte të sigurohej një nivel i mjaftueshëm i përgatitjes së përgjithshme të nxënësve si dhe të forcohej përgatitja profesionale. Sipas projektplaneve të reja mësimore të përgatitura dhe diskutuara gjatë vitit 1969, cikli i lëndëve të kulturës së përgjithshme dhe veçanërisht i lëndëve të shkencave të natyrës forcohej. Për shkollat profesionale, do të tentohej vendosja në nivel të përafërt të kulturës së përgjithshme për të arritur drejt unifikimit të tyre⁴⁷.

⁴⁵ *Po aty*, F. 511, V. 1969, D. 16, fl.80, Nga raporti i Ministrisë së Arsimit mbi zbatimin e detyrave të Plenumit VIII të KQ të PPSH, korrik 1969.

⁴⁶ *Po aty*, F. 14, V. 1971, D. 369, fl. 120-131, Nga protokoli i mbledhjes së Komisionit Qendror të Arsimit, dt. 14.2.1969.

⁴⁷ *Po aty*, F. 14, V. 1970, D. 369, fl. 174-175, Nga protokoli i mbledhjes së Komitetit Qendror të Arsimit, 8 maj 1969.

Në kuadrin e këtyre ndryshimeve, lënda e fizikës gjatë 4 viteve do të zhvillohej në gjimnaze në 560 orë, shkollat industriale 510 orë dhe ato bujqësore 450 orë, matematika respektivisht 310 orë në gjimnaze, 310 në shkollat industriale dhe 300 në ato bujqësore. Kështu p.sh. në shkollat e profilit mekanik, të agronomisë, cikli i lëndëve të kulturës së përgjithshme në vija të përgjithshme zinte 55 për qind të orëve teorike, nga 45 për qind të orëve të mëparshme. Ndërsa, grupi i lëndëve të shkencave të natyrës, 59 për qind të fondit të orëve të kulturës së përgjithshme për profilin mekanik dhe 51 për qind për atë të agronomisë, nga 42 për qind në planet ekzistuese⁴⁸. Në këto raporte, kultura e përgjithshme e shkollave profesionale vendosej në kuota të përafërta me ato të shkollës së mesme të përgjithshme duke rritur mundësitë për vazhdimin e studimeve të larta. Kjo evitonte defektin që ekzistonte deri në këtë periudhë, që nxënësit mund të vijonin shkollat e larta vetëm mbi bazën e profilit të shkollës së mesme të përfunduar.

Për sa i takonte lëndëve profesionale, volumit dhe shtrirjes së tyre, sipas një analize të bërë nga Komisioni Qendror i Arsimit në dhjetorin e vitit 1969, projektplanet e reja mësimore parashikonin që ato të zinin 45 për qind të orëve teorike, nga rreth 50 për qind në planet ekzistuese. Mendohej se kjo ulje sasiore, nuk ndikonte në nivelin e përgatitjes profesionale. Kjo për arsye se forcimi i lëndëve të shkencave të natyrës dhe dhënia e koncepteve dhe njohurive teorike bazë e bënte të nevojshme shkurtimin e disa lëndëve teknike. Në këto kushte njohuritë e marra në prodhim, do të ndihmonin në forcimin e njohurive teorike. që jepnin lëndët profesionale. Pozitivisht sipas një opinionit të përgjithshëm do të ndikonte edhe shpërndarja e harmonizuar e lëndëve të kulturës së përgjithshme gjatë 4 viteve.

Plani i ri mësimor i shkollave profesionale parashikonte që pa prishur lidhjet e brendshme, të mbështeste më mirë lëndët e profesionit në njohuritë e marra nga lëndët e shkencave të natyrës⁴⁹. Por ndonëse në një vështrim të shpejtë në raport me planet e mëparshme, ngarkesa javore pësonte një ulje, nga 32 në 30 orë në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe nga 36 në 32 orë në atë profesional, parë në aspektin e shpërndarjes

⁴⁸ *Po aty*, D. 301, fl.8, Nga Buletini nr.14 i Komisionit Qendror të Arsimit, Tiranë, janar 1970.

⁴⁹ *Po aty*, F. 14, V. 1970, D. 301, fl. 9, Nga Buletini nr. 14 i Komisionit Qendror të Arsimit, Tiranë, janar 1970.

së lëndëve formuese vërehej një ngjeshje më e theksuar në shkollat profesionale.

Gjatë hartimit të planeve, programeve dhe teksteve të reja mësimore të të gjitha kategorive shkollore u pretendua se ndryshimet e realizuara do të rrisnin nivelin cilësor. Pyetja që shtrohej në këtë rast do të ishte se çfarë niveli njohurish përfitonin nxënësit dhe studentët dhe a ishte ai i mjaftueshëm për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës. Një pjesë e ndryshimeve në drejtim të seleksionimit të njohurive të tepërta, rregullimit të raporteve midis lëndëve apo shtrirja më e mirë e tyre padyshim që ndikuan pozitivisht. *Por fakti që ndryshimet u bazuan në konsiderata politike dhe ideologjike, e dëmtuan procesin duke reflektuar në nivelin e përgjithshëm të njohurive që jepte shkolla dhe në mënyrë specifike në përmbajtjen e tyre.*

Duke nisur nga struktura e re e vitit shkollor, e organizuar sipas trekëndëshit “revolucionar” mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak në qendër të së cilit qëndronte boshti ideologjik marksist-leninist, kjo strukturë rritte ngarkesën mësimore. Nga 8-9 muaj, procesi mësimor tashmë do të zinte vetëm 6 muaj e gjysmë, i pasuar nga dy muaj punë prodhuese dhe një muaj edukim fizik e ushtarak.

Organizimi në këto proporcione realisht jo vetëm e preku, por e dëmtoi rëndë procesin mësimor. Ai prishi raportet tradicionale midis lëndëve, cunoi kohën e nevojshme për përvetësimin e bazave të shkencave, politizoi skajshëm përmbajtjen e disiplinave të ndryshme, duke çuar në uljen e nivelit të përgjithshëm të njohurive që ofronte shkolla e të gjitha kategorive.

Duke bërë një grupim të orëve të punës mendore dhe atyre të punës në prodhim e përgatitjes fizike e ushtarake, në planin e ri mësimor të shkollës fillore, 84 për qind të totalit të orëve e zinte procesi mësimor, në atë të 8-vjeçares 80,2 për qind dhe në shkollën e mesme kjo e fundit do të zinte vetëm 52,6 për qind. Në këto raporte më tepër prekej niveli i shkollës së mesme, kur pretendohet të ruheshin parametrat e mjaftueshëm për një nivel të duhur përgatitjeje të përgjithshme teorike të nxënësve. Pavarësisht nga kjo, nga strukturat shtetërore e ato partiake, ndryshimet e realizuara në fushën e dokumentacionit shkollor do të konsiderohen si të përshtatshme dhe, që krijonin mundësi të gjera “... që nxënësit të merrnin pjesë gjerësisht në prodhimin socialist, të përgatiten fizikisht dhe të

marrin pjesë në aksionet ideologjike të kohës”⁵⁰. Ky ishte dhe një nga synimet kryesore të reformës së re.

Nga viti shkollor 1969-1970 planet, programet dhe më tej tekstet mësimore që u nënshtruan ndryshimit, u futën gradualisht në praktikën mësimore. Planet dhe programet e reja u aplikuan fillimisht në të gjitha klasat e shkollës tetëvjeçare dhe pjesërisht të asaj të mesme. Në këto të fundit u fuqizuan lëndët e edukimit politik, edukatës së punës dhe formimit fizik e ushtarak. Në sistemin e arsimit të lartë, dokumentacioni i ri shkollor hyri në të gjitha kurset e para, duke u shtrirë gradualisht nga viti në vit. Vendosija e veprimtarisë mësimore edukative në të gjitha kategoritë shkollore mbi bazën e planeve, programeve dhe teksteve të reja, e thelloi më tej procesin e ideologjizimit dhe të tendenciozitetit klasor në të gjithë sistemin e edukimit shqiptar, duke e bërë atë të pakthyeshem deri në rënien e plotë të sistemit komunist në vitet 90-të.

S u m m a r y

THE TENDENCY TOWARDS A MARXIST-LENINIST IDEOLOGY OF THE ALBANIAN SCHOOL (1966-1970)

The period between 1966 and 1970 marks the time when the “New Reform” to “revolutionize the school” was initiated, a reform which left a lot of consequences in the future developments of the Albanian educational system.

The main principles of this reform were introduced in the “well known” Enver Hoxha’s speech of 7th March 1968. His “theories” served as the basis for the changes that were undertaken in all the education’s levels and categories in relation to the ideological and scientific aspects.

First of all the class struggle would be strengthened by increasing the number of subjects of political character. The new curricula and lesson plans would be overwhelmed with different elements of the political education. This process was intensified especially in 1969 when the reform “to revolutionize the school” entered a new more advanced phase.

The social subjects taught at school would be the focus of the changes in the curricula. Starting from 1966-1967 the subjects of language, literature,

⁵⁰ *Po aty*, F. 511, V. 1969, D. 54, fl. 58-60, Udhëzim i Ministrisë së Arsimit, dt. 7.09.1969.

history, etc. were “enriched” with “contemporary” topics. The subject of literature in particular, considering the importance it had to “revolutionize the schools’ youth”, was given a new dimension.

The changing process would involve the textbooks as well. This was a firm demand by the party-state. The idea was to review all the textbooks of all subjects removing everything that according to the party, was strange to the materialist-dialectic concepts. From 1969-70 these theoretical changes were gradually implemented in the teaching practice, thus irrevocably and further indoctrinating the new generations until the eventual fall of the communist system in the 1990’s.

